

# ZOTIMET E PROGRAMIT QEVERISËS

The logo for the LDK 113 electoral list. It features the text "LDK 113" in a bold, white, sans-serif font. Above the text is a stylized graphic consisting of two overlapping, curved, light blue shapes that resemble a double-headed arrow or a stylized 'D'.

LIDHJA  
DEMOKRATIKE  
E KOSOVËS

# 10

## ZOTIMET KRYESORE

- 1 PAGA MË TË LARTA – MENJËHERË**  
koeficienti 150 dhe dyfishim i pensioneve
- 2 PUNË PËR ÇDO TË DIPLOMUAR**  
punësim i garantuar dhe trajnim për 40 mijë të rinj
- 3 ULJE E ÇMIMEVE**  
moratorium i çmimeve të energjisë dhe ulje e çmimeve të produkteve bazike
- 4 ALEANCË E PATHYESHME  
ME PERËNDIMIN**  
Kosova në NATO e BE, përfaqësim dinjitoz, partneritet strategjik, siguri kombëtare, besueshmëri ndërkombëtare.

**5 PAVARËSI ENERGJETIKE PËR KOSOVËN**  
central i ri me gaz amerikan (LNG)

**6 KOSOVA E LIDHUR PËRMES  
INFRASTRUKTURËS RRUGORE**  
përfundimi i autostradave dhe  
magjistrave brenda mandatit

**7 DHJETËRA-MIJËRA VENDE TË  
REJA PUNE**  
investitor strategjik në ICT dhe  
ekonomi digjitale

**8 MBËSHTETJE PËR FAMILJEN – ME LIGJ**  
shtesa të garantuara për fëmijë, lehona,  
gra kujdestare dhe pensionistë

**9 SPITALI I RI I KOSOVËS**  
kujdes shëndetësor modern e dinjitoz

**10 MËSIM TËRËDITOR PËR FËMIJËT TANË**  
në secilën komunë të Kosovës

**BASHKOHU!**



## KAPITULLI I

# KOSOVA – SHTET I JETËS SË DINJITESHME

Prioriteti i parë i qeverisë së LDK-së është lehtësimi i drejtpërdrejtë i koston së jetesës për çdo familje kosovare.

Masat e mëposhtme hyjnë në fuqi që në vitin e parë të qeverisjes: pa kushte, pa procedura burokratike dhe me efekt të matshëm në mirëqenien e secilit qytetar

## **1 MORATORIUM I RITJES SË ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR 3 VITE**

LDK zotohet të vendosë një moratorium të plotë të rritjes së çmimeve të energjisë elektrike për qytetarët për tre vitet e ardhshme.

Asnjë rritje e çmimeve të energjisë nuk do të lejohet gjatë kësaj periudhe, pavarësisht luhatjeve të tregut ndërkombëtar të energjisë.

Kjo masë mbron menjëherë buxhetin familjar nga rritjet e papritura. Diferenca e kostove mbulohet përmes fondit të stabilizimit të tregut të energjisë.

## **2 ZERO TVSH NË FATURAT E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Heqja e TVSH-së nga faturat e energjisë elektrike ul direkt pagesën mujore të çdo familjeje: pa asnjë procedurë aplikimi, pa kriteret kualifikimi.

Efekti është universal dhe i menjëhershëm nga muaji i parë i qeverisjes. Ndikimi vjetor i kombinuar për familjen mesatare arrin 350 –500 euro në vit.

### **3 RRRITJA E MENJËHERSHME E PAGAVE: KOEFICIENTI 150**

Koeficienti i pagave në sektorin publik rritet menjëherë nga 110 euro në 150 euro, që korrespondon me një rritje prej rreth 36% për shumicën e punonjësve.

Asnjë punonjës i sektorit publik nuk do të marrë pagë nën 600 euro neto, dhe asnjë pensionist nuk do të mbetet nën 300 euro.

### **4 DYFISHIM I PENSIONEVE**

Çdo pensionist kosovar do të marrë pension bazë mbi 300 euro në muaj, nivel që mundëson jetesë dinjitoze, jo vetëm mbijetesë.

Kjo nuk paraqet vetëm një të drejtë të fituar përmes kontributeve shumëvjeçare, por edhe detyrim moral të shtetit ndaj brezit

## **5 BANESA PËR FAMILJET E REJA**

LDK subvencionon interesat e kredive hipotekare për çdo blerës të banesës së parë deri në vlerën 100,000 euro. Kjo do të thotë se kostoja reale e kredisë ulet ndjeshëm, duke e bërë blerjen e banesës të arritshme për çiftet e reja. Gjithashtu krijohen skema qiraje me mundësi blerje.

Nuk do të ketë monopol shtetëror të banesave, por do të ketë garanci se çifti i ri që punon dhe kontribuon mund të blejë shtëpi pa u varur nga familja apo nga bankat me kushte të rënda.

## **6 PUNËSIM I GARANTUAR PËR SECILIN TË SAPODIPLOMUAR**

Çdo punëdhënës privat që punëson të diplomuar të rinj deri në moshën 25 vjeç, përfiton subvencionim prej 500 euro në muaj për pagën, për një periudhë prej 6 deri 12 në muaj.

Programi financon direkt 15,000 vende të reja pune në vit.

Qëllimi kryesor është ndalimi i largimit të të talentuarve. Çdo i ri që qëndron është fitim i trefishtë për ekonominë kosovare.

## **7 400 INSPEKTORË TË PUNËS PËR TË GARANTUAR TË DREJTAT E PUNËTORËVE**

Numri i inspektorëve të punës dhjetëfishohet, nga 40 në 400 inspektorë aktivë. Qëllimi është i qartë: çdo punëtor kosovar merr atë që i takon sipas kontratës së punës: pagën e plotë, shtesat ligjore dhe respektimin e normës 40-orëshe të punës në javë. Punëdhënësit që abuzojnë me punëtorët do të përballen me gjyba të rënda dhe masë administrative.

## **8 KTHIMI I PLOTË I PARAVE TË VJEDHURA PËRMES MANIPULIMIT TË NJEHSORËVE ELEKTRIKË**

LDK zotohet të hetojë dhe të ndjekë penalisht çdo rast të vjedhjes dhe manipulimit të njëhsorëve elektrikë. Të gjitha shumatat e konstatuara si të përfituara në mënyrë të paligjshme nga kjo vjedhje do t'u kthehen plotësisht konsumatorëve të dëmtuar. Ky proces kërkon një audit të plotë të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe transparencë të plotë nga operatori i sistemit të shpërndarjes.

## **9 PEZULLIMI I AKCIZËS PËR NAFTËN DHE TVSH 0% GJATË KRIZAVE GLOBALE**

Në rastet e krizave globale që shkaktojnë rritje të paparashikuar të çmimeve të karburanteve dhe të mallrave bazë, LDK do të zbatojë menjëherë dy masa mbrojtëse: pezullimin e mbledhjes së akcizës për naftën dhe aplikimin e normës 0% të TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e nevojshme gjatë kësaj periudhe.

Këto masa janë të përkohshme dhe proporcionale, të lidhura drejtpërdrejt me luhatjet e tregjeve ndërkombëtare.

Qytetarët nuk do të mbeten pa mbrojtje në kohët kur kriza ekonomike globale godet xhepat e familjeve kosovare. Shteti duhet të jetë i pari që vepron për të mbrojtur fuqinë blerëse të qytetarëve.

## **10 ULJE E ÇMIMEVE TË PRODUKTEVE BAZIKE**

Heqje e TVSH-së për të gjitha produktet bazike në Kosovë, përfshirë bukën, qumështin, vajin, vezët, miellin, sheqerin dhe produktet e tjera të shportës së konsumatorit, përmes masave të lartpërmendura.

## **11** KTHIMI I TVSH-SË 2%

Çdo blerje e regjistruar me QR-kod sjell një kthim automatik prej 2% të TVSH-së direkt në llogarinë e konsumatorit.

Sistemi funksionon pa formularë dhe pa pritje administrative.

Kjo masë ka dy qëllime njëkohësisht: i kthen konsumatorit një pjesë të taksave dhe detyron bizneset të punojnë në mënyrë formale.

Një familje mesatare vlerësohet se do të kursejë 150–250 euro në vit.



## KAPITULLI II

# KOSOVA – SHËNETËSISË MODERNE

Shëndetësia është e drejta themelore e çdo qytetari. LDK do të investojë masivisht në infrastrukturë, pajisje dhe personel shëndetësor, përmes investimeve konkrete, buxheteve të përcaktuara dhe afateve të qarta, duke e vendosur pacientin në qendër të sistemit shëndetësor.

## **12 QKUK E RE: 500 MILIONË EURO**

LDK angazhohet të ndërtojë një qendër të re spitalore universitare me 38 klinika moderne, të organizuara sipas standardeve evropiane, në dy faza përgjatë 6 viteve.

Ky është projekti më i madh i investimit publik në historinë e shëndetësisë kosovare. Qëllimi është i drejtpërdrejtë: pacientët kosovarë nuk do të detyrohen të udhëtojnë jashtë vendit për trajtim të nivelit evropian.

Çdo euro e shpenzuar brenda vendit është euro e kursyer nga xhepat e familjeve dhe euro e investuar në dinjitetin e qytetarit.

## **13 PAJISJE MJEKËSORE TË REJA: 100 MILIONË EURO**

Brenda dy viteve të para të mandatit, 100 milionë euro do të investohen direkt për pajisje diagnostike dhe terapeutike sipas listave të nevojave reale të çdo klinike.

Investimi ul koston për pacientët, redukton listat e pritjes dhe ngrit standardin e diagnostikimit.

## **14** SPECIALIZIM DHE PUNËSIM I GARANTUAR PËR MJEKËT

Çdo mjek i diplomuar kosovar do të ketë qasje të garantuar në specializim dhe vend pune brenda sistemit publik shëndetësor. Mungesa e vendeve të specializimit ka qenë shkaku kryesor i largimit të mjekëve nga Kosova.

Mjekët që zgjedhin të punojnë në zonat rurale ose në zonat me mungesë personeli, do të marrin paga shtesë dhe kushte pune shtesë.

Investimi në mbajtjen e mjekëve është investim për një nga ngritjet më të larta në sistemin shëndetësor.

## **15** SIGURIMET SHËNDETËSORE

Sistemi i sigurimeve shëndetësore nis në vitin e parë të mandatit me kontribute të barabarta: 3.5% nga punëdhënësi dhe 3.5% nga punëmarrësi.

Viti i parë mbulohet tërësisht nga buxheti qendror, duke i dhënë kohë sistemit për t'u organizuar.

Rreth 150 milionë euro duhet të investohen që në fillim në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore.

Ky model është standardi i provuar i të gjitha vendeve të BE-së.

Ai krijon burim të qëndrueshëm financimi, shpërndan barrën mes të gjithë kontribuuesve dhe garanton që qasja në shërbimet shëndetësore të mos varet nga faturat e tjera që duhet të paguhen.

## **16** KARTELA SHËNDETËSORE

Me një investim prej 30 milionë euro, LDK ndërton platformën e integruar kombëtare shëndetësore përmes së cilës historiku i plotë mjekësor i çdo qytetari do të jetë i qasshëm nga çdo mjek, kudo në Kosovë.

Platforma eliminon dublikimet e testeve, ul kostot e sistemit shëndetësor dhe rrit sigurinë e pacientit përmes qasjes së shpejtë dhe të sigurt në të dhënat shëndetësore.

## **17** MENAXHIM PROFESIONAL I KLINIKAVE

Kompanitë profesionale të menaxhimit kontraktohen për administrimin operacional të klinikave, ndërsa mjekët fokusohen tërësisht te pacientët, jo te burokracia administrative dhe menaxhimi.

Ky model nuk privatizon shërbimin shëndetësor, por vetëm menaxhimin administrativ të klinikave.

Rezultatet e pritshme përfshijnë ulje të shpenzimeve operative deri në 20% dhe rritje të kënaqësisë së stafit dhe pacientëve. Standardet mbeten publike dhe nën kontroll të shtetit.

## **18** NDËRTIMI I SPITALIT RAJONAL NË MITROVICË, MBI LUMIN IBËR

Nisja dhe përfundimi i punimeve në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, godinë që bashkon jugun me veriun; si investimi më i madh në sistemin shëndetësor në historinë e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Emiratet e Bashkuara Arabe.

## **19 MBULIM I GARANTUAR, I PLOTË DHE I GJITHHERSHËM I BARNAVE ESENCIALE**

Qytetarët e Kosovës nuk duhet të përballen me shpenzime personale për barnat esenciale për shkak të mungesave në sistemin publik shëndetësor.

Prandaj, do të garantojmë mbulim të plotë dhe të gjithëshëm të listës së barnave esenciale në të gjitha institucionet publike shëndetësore, përmes reformimit të sistemit të furnizimit, planifikimit dhe menaxhimit të stokut, eliminimit të mungesave kronike dhe rritjes së transparencës.

Përmes digjitalizimit të zinxhirit të furnizimit dhe planifikimit afatgjatë të nevojave, çdo qytetar do të ketë sigurinë e qasjes së vazhdueshme në terapinë e nevojshme. Barnat esenciale nuk do të varen më nga rastësia, por do të jenë garanci e Republikës.

## 20 SHËNDETI MENDOR



Shëndeti mendor nuk mund të mbetet më në heshtje, në pritje apo në margjinat e sistemit shëndetësor.

Në programin tonë, shëndetin mendor do ta trajtojmë si pjesë themelore të mirëqenies së qytetarëve, përmes investimeve konkrete në shërbime psikologjike dhe psikiatrike, mbështetjes së veçantë për fëmijët, të rinjtë dhe familjet, si dhe programeve të dedikuara për mirëqenie emocionale në shkollat e mesme.

Do të krijojmë një linjë të veçantë kombëtare të thirrjeve për mbështetje psikologjike, të financuar dhe të mbështetur nga vetë shteti dhe e qasshme 24 orë në ditë, ku çdo qytetar që përballet me krizë emocionale, ankth apo nevojë për këshillim do të mund të marrë mbështetje profesionale dhe të besueshme.

Sepse një shoqëri e shëndetshme nuk ndërtohet vetëm me kujdes për trupin, por edhe me kujdes për shëndetin mendor.



## KAPITULLI III

# KOSOVA – SHTETI I DIJES

Arsimi është investimi më i rëndësishëm që bën shteti në kapitalin njerëzor, në të ardhmen dhe në konkurrueshmërinë e vendit.

LDK do të investojë me vendosmëri dhe me buxhete konkrete në arsimin parauniversitar dhe profesional.

## **21** MËSIMI TËRËDITOR: 1 MILIARD EURO

LDK investon 1 miliard euro gjatë katër viteve për implementimin e mësimit tërëditor në çdo komunë të Kosovës. Fëmijët përfitojnë kujdes, ushqim të shëndetshëm dhe aktivitete edukative gjatë gjithë ditës.

Ky investim ka dy efekte të drejtpërdrejta njëkohësisht: rrit cilësinë e arsimit dhe i liron prindërit, veçanërisht nënat, duke u mundësuar të punojnë me orar të plotë. Çdo euro e investuar kthen dy euro në ekonomi përmes punës shtesë dhe tatimeve.

## **22** ÇERDHE PUBLIKE TË REJA

20 Çerdhe publike të reja ndërtohen çdo vit, përkatësisht 80 gjatë mandatit, me një buxhet total prej 160 milionë euro.

Edukimi i hershëm përbën bazën e rëndësishme shkencore për suksesin shkollor dhe profesional, si dhe u mundëson nënave të angazhohen aktivisht në tregun e punës.

Çerdhet do të ndërtohen me prioritet në zonat me mungesë të theksuar kapacitetesh, duke garantuar qasje universale pavarësisht vendbanimit. Tarifat e shërbimit në çerdhe do të subvencionohen për familjet me të ardhura të ulëta.

## **23** **ARSIMI PROFESIONAL DHE MODELI DUAL**

LDK do të forcojë dhe financojë arsimin profesional përmes modelit dual gjerman, ku nxënësit e ndajnë kohën mes shkollës dhe praktikës në kompani.

Programet zhvillohen në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me bizneset kosovare, të cilat do të jenë punëdhënësit potencialë.

Shkolla profesionale e fortë zvogëlon papunësinë e të rinjve, plotëson nevojat reale të tregut të punës dhe ofron një rrugë të dinjitetshme karriere për ata që nuk zgjedhin universitetin.

## 24 SIGURI E PLOTË NË SHKOLLA



Shkolla duhet të jetë vend i dijes, i sigurisë dhe i qetësisë për çdo fëmijë. Prandaj, do të ndërtojmë një qasje të re për sigurinë në shkolla, duke nisur me programe të veçanta kundër dhunës psikologjike, bullizmit dhe përjashtimit social, përmes angazhimit të psikologëve shkollorë, edukimit emocional dhe mekanizmave të hershëm të identifikimit dhe mbështetjes për nxënësit.

Njëkohësisht, përmes forcimit të policimit në lagje dhe koordinimit të drejtpërdrejtë me institucionet arsimore, do të garantohet mbrojtje më e madhe e shkollave nga dukuritë kriminale, shpërndarja e substancave narkotike dhe çdo rrezik që cenon sigurinë e fëmijëve tanë. Sepse prindi duhet ta dërgojë fëmijën në shkollë me besim të plotë, e fëmija duhet të rritet në një ambient që e mbron, e edukon dhe e fuqizon.

## **25** GARANCI PËR CILËSI NË PUNËSIMIN E MËSIMDHËNËSVE

Cilësia e arsimit fillon me cilësinë e mësimitdhënësve. Prandaj, do të vendosim një standard të ri kombëtar për hyrje në profesionin e mësimitdhënies, i cili do të vlejë për të gjitha aplikimet e reja në sistemin publik arsimor.

Përmes një qendre kombëtare të testimit dhe vlerësimit profesional, kandidatët për mësimitdhënës do të vlerësohen sipas standardeve të qarta profesionale dhe kurrikulare, ndërsa rezultatet do të shërbejnë për rangim transparent dhe meritore në procesin e punësimit.

Kjo qasje nuk i prek mësimitdhënësve aktualë, por garanton që çdo hyrje e re në sistem të mbështetet në meritë, profesionalizëm dhe cilësi, duke eliminuar keqpërdorimet dhe duke ngritur standardin e arsimit në vend.



## KAPITULLI IV

# KOSOVA – SHTET I ENERGJISË

Energjia e besueshme dhe me çmim të përbalueshëm është kusht themelor për industrinë dhe jetën moderne.

LDK angazhohet për diversifikimin e burimeve të prodhimit, reduktimin e varësisë nga importi dhe garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike: si për familjet ashtu edhe për bizneset.

## **26** **CENTRALI ME GAZ** **AMERIKAN 500 MW**

LDK do të jetësojë ndërtimin e centralit të ri elektrik me gaz natyror të lëngshëm amerikan (LNG), me kapacitet prej 500 megavatësh dhe investim prej rreth 500 milionë eurosh. Ky central siguron kapacitete bazë të qëndrueshme dhe redukton varësinë kritike nga importi, veçanërisht gjatë periudhave të konsumit të lartë dimëror.

Përdorimi i gazit natyror në prodhimin e energjisë, plotëson standardet e BE-së dhe pozicionon Kosovën si nyje të re të sigurisë energjetike rajonale.

Partneriteti me SHBA-në ka dimensione edhe strategjike, jo vetëm ekonomike, përfshirë edhe ndaljen e ndikimit të mafies energjetike me bazë në vendet armiqësore që cenojnë sigurinë kombëtare të Kosovës.

## 27 GAZIFIKIMI I KOSOVËS



Linja e gazit nga Hani i Elezit deri në Mitrovicë, me vlerë rreth 120 milionë euro, do të mundësojë furnizimin me gaz natyror amerikan përmes rrjetit ekzistues të Maqedonisë së Veriut.

Projekti integron Kosovën për herë të parë në korridoret energjetike evropiane. Gazifikimi nuk është vetëm çështje energjetike, por edhe vendim strategjik i politikës së jashtme dhe sigurisë. Kosova e lidhur me rrjetet energjetike amerikane është Kosovë më e sigurt dhe e ancoruar edhe më fort me orientimin euroatlantik.

LDK, po ashtu, do të hapë perspektivën për gazifikimin e thëngjillit në bashkëpunim me partnerët amerikanë.

## 28 500 MW ENERGJI SOLARE DHE 500 MW ENERGJI NGA ERA



Investimet në energjinë e rinovueshme do të realizohen përmes modelit të partneritetit publiko-privat (PPP): kapitali privat investon, shteti rregullon dhe siguron tokën, si dhe ambientin e investimit.

Parqet e erës janë të planifikuara në mënyrë strategjike, pasi prodhimi i tyre është më i lartë gjatë dimrit, kur kërkesa për energji arrin nivelet maksimale.

Diversifikimi i burimeve e bën sistemin energjetik rezistent ndaj goditjeve: nëse njëri burim dështon, të tjerët e mbulojnë.

## **29** **PROSUMERËT: QYTETARËT PRODHOJNË ENERGJI**

Çdo familje apo biznes që instalon panele solare do të ketë mundësinë të shesë energjinë e tepërt direkt në rrjetin elektrik.

Ky program ul faturën e energjisë për prosumerët, diversifikon rrjetin dhe shpërndan investimet në sektorin energjetik.

## **30** **EFIÇENCA ENERGJETIKE: ULJE DERI NË 20% E KONSUMIT**

Programet kombëtare për izolimin e ndërtesave, zëvendësimin e pajisjeve joefiçiente dhe rinovimin e fasadave mund të ulin konsumin total të energjisë deri në 20%.

Ky është investimi me kthimin më të shpejtë në sektorin e energjisë. Çdo euro e investuar në efikasitet energjetik kursen 3–4 euro të shpenzimeve afatgjata.

LDK do të financojë 50–70% të kostove të izolimit për familjet me të ardhura të ulëta, përmes skemave subvencionuese.

## **31** **PLANI KOMBËTAR PËR VETURA ELEKTRIKE**

LDK harton dhe zbaton Planin Kombëtar për Vetura Elektrike, që synon përshtetimin e kalimit drejt mobilitetit të qëndrueshëm me energji të pastër.

Plani përfshin zhvillimin e infrastrukturës së mbushjes, stimujt fiskalë dhe kuadrin rregullator për t'i bërë veturat elektrike të arritshme për familjet kosovare.

Norma e TVSH-së për vetura elektrike dhe për mbushësit e shpejtë vendoset në 0%, duke ulur drejtpërdrejt koston e blerjes dhe të instalimit.

Kjo masë nënvizon angazhimin e LDK-së drejt tranzicionit të gjelbër energjetik dhe uljes së varësisë nga karburantet fosile.

## **32** **DYFISHIMI I RRJETIT TË KOGJENERIMIT**

Aktualisht, rreth gjysma e kapaciteteve të KEK-ut të dedikuara për projektin e kogjenerimit shfrytëzohet për ngrohjen qendrore në komunat e Prishtinës dhe Obiliqit.

Pjesa tjetër e kapacitetit do të përdoret për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes qendrore në këto dy komuna.

Kostoja financiare e dyfishimit të kogjenerimit do të jetë rreth 120 milionë euro, ku pjesa më e madhe - sikurse deri më tani - do të financohet përmes kredive të buta afatgjata dhe donacioneve.



## KAPITULLI V

# KOSOVA – SHTETI I ALEANCAVE

Aleanca e pathyeshme me Perëndimin

Kosova në NATO e BE, Përfaqësim dinjitoz,  
partneritet strategjik, siguri kombëtare, besueshmëri  
ndërkombëtare.

## **33** BESIM, SIGURI, PARTNERITET STRATEGJIK ME SHBA

LDK do të institucionalizojë partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si bosht të pandryshueshëm të politikës së jashtme dhe sigurisë së Kosovës.

Ky partneritet do të thellohet përmes harmonizimit të plotë të politikës së jashtme dhe të sigurisë, si dhe të zgjerimit të bashkëpunimit në fushat e mbrojtjes, inteligjencës dhe ekonomisë strategjike.

Përfshirja në mekanizma strategjike të sigurisë nën lidërsipin amerikan si Board of Peace, pjesëmarrja në misione paqeruajtëse së bashku me ushtrinë amerikane, si dhe zgjerimi i marrëveshjeve strategjike me SHBA-në në fushën politike, diplomatike, të sigurisë, të mbrojtjes dhe të ekonomisë, do të institucionalizohen si shtylla themelore të mbrojtjes së shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës.

## **34 ANËTARËSIM I KOSOVËS NË NATO**

Qeveria e udhëhequr nga LDK do ta realizojë anëtarësimin e Kosovës në NATO brenda këtij mandati nëpërmjet partneritetit të afërm me SHBA-në, rritjes së ndërveprueshmërisë me forcat aleate dhe konsolidimit të rolit të Kosovës si kontribuese në sigurinë rajonale e globale.

## **35 NJOHJA NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS**

Njohja nga shumica dërmuese e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, si dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare që rrjedh prej saj, janë objektiva që do t'i realizojmë gjatë këtij mandati, si pjesë e përpjekjeve për konsolidimin e plotë të pozitës së Kosovës në komunitetin ndërkombëtar.

## **36** MARRJA E STATUSIT TË VENDIT KANDIDAT PËR NË BE

LDK do të punojë me shtetet anëtare të BE-së, për të avancuar menjëherë marrjen e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian.

Zbatimi i Planit të Rritjes do të trajtohet si prioritet ekzekutiv me koordinim të plotë me BE-në dhe me një plan të dedikuar nacional, duke siguruar transformim të shpejtë ekonomik dhe institucional.

LDK do ta trajtojë përshpejtimin e integritimit në Bashkimin Evropian si objektiv nacional, duke ndërtuar një model “fast-track alignment” të bazuar në praktikat e shteteve të vogla me performancë të lartë si Estonia, Kroacia dhe Sllovenia.

## **37** FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË MBROJTJES DHE NDËRVEPRUESHMËRISË ME NATO-N

LDK do të përshpejtojë transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë moderne, profesionale dhe plotësisht të ndërveprueshme me NATO-n.

Bashkëpunimi në fushën e pajisjeve strategjike, trajnimit dhe doktrinës ushtarake do të rrisë kapacitetin mbrojtës të Kosovës dhe rolin e saj si faktor stabiliteti rajonal dhe global.

## **38** RISHIKIMI STRATEGJIK I DIALOGUT ME SERBINË

LDK angazhohet për rishikim strategjik të dialogut me Serbinë si proces politik i lehtësuar nga Bashkimi Evropian dhe i mbështetur nga SHBA, me objektiv të qartë të njohjes reciproke brenda kufijve ekzistues të Republikës së Kosovës.

Me LDK-në, do të fuqizohen parimet kryesore të dialogut me Serbinë: integriteti territorial, rendi kushtetues, dhe karakteri unitar i shtetit.

LDK nuk e njeh, nuk e pranon dhe nuk do ta zbatojë draft-statutin aktual të Asociacionit të propozuar nga Miroslav Lajçak.

## **39** DIPLOMACIA EKONOMIKE E INTEGRUAR NË PARTNERITETIN TRANSATLANTIK

LDK do ta thellojë integrimin ekonomik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian përmes marrëveshjeve strategjike, me prioritet projektet e gazifikimit LNG, infrastrukturës dhe inovacionit.

Kosova do të pozicionohet si destinacion i besueshëm për investime strategjike në sektorët kritikë të zhvillimit.

## **40** UNITET I BRENDSHËM SHTETËROR PËR POLITIKË TË JASHTME DHE PËRBALLJE ME SERBINË

LDK do të sigurojë koordinim të plotë institucional dhe do të synojë unitet në politikën e jashtme për vazhdimësi strategjike dhe besueshmëri ndërkombëtare.

Politika e jashtme e Kosovës do të udhëhiqet përmes një sistemi të unifikuar shtetëror, i bazuar në partneritet afatgjatë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n.



## KAPITULLI VI

# KOSOVA – SHTET ME SIGURI KOMBËTARE

Siguria kombëtare ndërtohet mbi tre shtylla të qëndrueshme: Forcën e Sigurisë së Kosovës profesionale dhe të pajisur mirë, anëtarësim formal progresiv në NATO si objektivi strategjik dhe kapacitete moderne kibernetike dhe elektronike.

## **41 BUXHETI I MBROJTJES MBI 3% TË GDP-SË**

LDK do të rrisë gradualisht buxhetin e mbrojtjes përtej standardit 3% të BPV-së. Investimet prioritare fokusohen në pajisjet moderne, stërvitje dhe trajnime të vazhdueshme, mbështetjen e mirëqenies së ushtarakëve dhe rritjen e ndërveprueshmërisë me forcat e NATO-s.

## **42 KATËR KAZERMA TË REJA DHE INFRASTRUKTURË USHTARAKE**

LDK do të ndërtojë katër kazerma të reja në Prizren, Gjinoc, Gjakovë dhe Podujevë, me një investim prej 60 milionë eurosh.

Vendbanimet pranë kazermave do të ofrojnë kushte të dinjitetshme sociale për pjesëtarët e FSK-së dhe familjet e tyre.

## **43 KAPACITETET KIBERNETIKE DHE “SMART DEFENCE”**

Bashkëpunimi i ngushtë me SHBA-në dhe NATO-n do të fuqizojë kapacitetet elektronike dhe kibernetike të FSK-së.

Lufta kibernetike është dimension i ri dhe ndoshta më kritik i sigurisë kombëtare. Kosova duhet të jetë e gatshme dhe e aftë në këtë fushë.

“Smart Defence” mundëson përdorimin optimal të burimeve mbrojtëse. Efiçenca buxhetore do të zbatohet edhe në fushën e mbrojtjes, duke investuar aty ku ndikimi është maksimal.

## **44** PAGESA E SHITESAVE PËR RREZIKSHMËRI, PËR KUJDESTARI DHE MËDITJET GJATË GJITHË SHKOLLIMIT DHE TRAJNIMIT

Forca e Sigurisë së Kosovës ka aset më të rëndësishëm njerëzit e saj; burra e gra që i shërbejnë Republikës në kushte të veçanta, me disiplinë të lartë dhe ekspozim të vazhdueshëm ndaj rrezikut.

Prandaj, do të sigurojmë trajtim më të drejtë financiar për pjesëtarët e FSK-së përmes zbatimit të shtesave për rrezikshmëri sipas nivelit të ekspozimit gjatë misionëve, stërvitjeve dhe detyrave operacionale.

Po ashtu, do të sigurohet pagesa e rregullt për punën me ndërrime, kujdestaritë dhe angazhimet jashtë orarit.

Kjo nuk është vetëm çështje kompensimi, është edhe çështje dinjiteti, motivimi dhe respekti institucional për ata që mbrojnë vendin.

Njëkohësisht, do të mbështesim zhvillimin profesional të kuadrove të FSK-së duke garantuar mbulim të plotë të mëditjeve për shkollimet, trajnimet dhe specializimet jashtë vendit gjatë gjithë periudhës.

Nuk mund të kërkojmë ushtri moderne, të ndërveprueshme me partnerët tanë strategjikë dhe të përgatitur sipas standardeve më të larta, pa krijuar kushtet që ushtarakët tanë të trajnohen denjësisht dhe pa pengesa financiare.

Kujdesi për pjesëtarët e FSK-së është kujdes për sigurinë kombëtare.

Një forcë e motivuar, e trajtuar drejt dhe e përgatitur profesionalisht është garancia më e mirë për një Kosovë më të sigurt, më të mbrojtur dhe më të gatshme për çdo sfidë.

## **45** SIGURIMI SHËNDETËSOR PËR USHTARAKËT E FSK-SË

Shërbimi i sigurimit shëndetësor për ushtarakët e FSK-së ndërlidhet me çështjen e rreziqeve potenciale për shëndetin e tyre, vazhdimisht të ekspozuar në detyrat e tyre gjatë shërbimit, stërvitjeve dhe operacioneve brenda dhe jashtë vendit.

Ky shërbim do të funksionalizohet përmes një akti të veçantë ligjor.

## **NDËRTIMI I SPITALIT USHTARAK**

**46** Shëndeti dhe mirëqenia e ushtarakëve tanë janë thelbësore për gatishmërinë dhe aftësinë e tyre për të kryer detyrat me sukses. Prandaj, ndërtimi i një spitali ushtarak modern, i pajisur me infrastrukturë dhe pajisje të avancuara mjekësore, do të ofrojë shërbime shëndetësore cilësore deri në nivelin terciar për ushtarakët tanë dhe familjet e tyre, për pjesëtarët e institucioneve të tjera të sigurisë, për familjet e policëve të rënë në detyrë, si dhe për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës dhe familjet e tyre.

## **47** **SIGURIMI I BANIMIT** **PËR USHTARAKËT**

Në përpjekjen për të rritur efikasitetin dhe gatishmërinë operacionale të FSK-së, është e nevojshme të sigurohen kushte të mira banimi për ushtarakët tanë. Prandaj, LDK do ta zbatojë programin për ndërtimin e banesave të përshtatshme për ushtarakët dhe policët tanë, si dhe familjet e tyre.

Kjo do të rrisë moralin, përkushtimin dhe motivimin për t'i shërbyer vendit, duke u siguruar atyre një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për jetesë dinjitoze.

Ushtarakëve do t'u sigurohen edhe kredi të favorshme dhe lehtësira, në përputhje me praktikën e shumicës së vendeve demokratike.



## KAPITULLI VII

# KOSOVA – SHTET ME DREJTËSI

Drejtësia funksionale dhe sundimi i ligjit janë kushtet bazë të çdo investimi, çdo zhvillimi dhe çdo besimi qytetar.

Pa gjyqësor të pavarur, pa polici të ndershme dhe pa llogaridhënie reale, asnjë premtim tjetër ekonomik nuk është i besueshëm.

## **48** REFORMA E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE KËSHILLIT PROKURORIAL

Transparenca, profesionalizmi dhe llogaridhënia bëhen standardi i detyrueshëm i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial.

Anëtarët e këtyre këshillave i nënshtrohen vlerësimit të pavarur të performancës dhe proceseve rigoroze të emërimit.

Pavarësia e drejtësisë fillon me reformën e organeve vetëqeverisëse dhe jo me presionin nga politika. Gjyqtari dhe prokurori duhet të jenë të pavarur nga politika apo çdo ndikim tjetër, por të llogaridhënshtëm ndaj Kushtetutës dhe ligjeve - ky është standardi ynë.

## **49** DIGJITALIZIMI I PLOTË I DREJTËSISË

Menaxhimi elektronik i lëndëve, seancave dhe komunikimit gjyqësor eliminon vonesat artificiale dhe krijon transparencë totale.

Qytetarët dhe avokatët do të mund të ndjekin çdo lëndë online, në kohë reale - pa nevojën e telefonatave dhe vizitave fizike në gjykata.

Sistemi digjital gjyqësor gjithashtu e bën të pamundur manipulimin e proceseve administrative dhe caktimin e rasteve.

## **50** GJYKATAT E SPECIALIZUARA PËR KRIMET EKONOMIKE

Dhomat ose gjykatat e specializuara për krimet ekonomike dhe korrupsionin e nivelit të lartë do të funksionalizohen me gjyqtarë të certifikuar posaçërisht.

Specializimi garanton cilësi më të lartë të gjykimit, ndërsa lëndët komplekse financiare do të trajtohen nga gjyqtarë që i kuptojnë në thelb këto çështje.

Asnjë politikan i korruptuar, biznesmen i korruptuar, zyrtar publik apo individ me ndikim nuk do të qëndrojë mbi ligjin.

## **51 VETING NË POLICI DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT**

Reforma e vetingut në polici pastron radhët e saj nga elementët e korruptuar dhe garanton integritet profesional të gjithë forcës.

Personat që denoncojnë rastet e korruptionit do të mbrohen me ligj të fortë dhe me struktura efektive mbështetëse.

## **52 QENDRA KOMBËTARE KUNDËR EKSTREMIZMIT DHE TERRORIZMIT**

Qendra koordinon analizën dhe parandalimin e kërcënimeve ekstremiste, në bashkëpunim të ngushtë me EUROPOL dhe INTERPOL.

Lufta kibernetike trajtohet si një dimension me të njëjtin nivel serioziteti si siguria fizike.



## KAPITULLI VIII

# KOSOVA – SHTET I PRODHIMIT

Kosova është ndër vendet me rezervat minerale më të pasura në Evropë. Për dekada kemi eksportuar lëndë të parë dhe kemi importuar produkte të gatshme.

LDK do ta ndryshojë këtë ekuacion: riindustrializim i bazuar në konkurrueshmëri, përpunim vendor dhe eksport të produkteve finale me vlerë të shtuar.

## **53** TREPÇA: 200 MILIONË EURO INVESTIM

LDK, brenda mandatit, investon 200 milionë euro para nga buxheti publik, dhe përmes PPP-ve – në Trepçë dhe në kompleksin minerar të Kosovës.

Fokusi nuk është vetëm nxjerrja e xehes, por edhe ndërtimi i linjave të plota të përpunimit: nga nxjerrja deri te metali i rafinuar dhe produkti industrial i gatshëm.

Zinku, plumbi dhe metalet e tjera të Kosovës do të dalin si produkte të finitura me markë kosovare, jo si xehe të papërpunuara. Ky model trefishon vlerën e eksportit dhe krijon 2,000–3,000 vende pune direkte me paga dinjitoze.

Trepça është simbol industrial, ndërsa LDK e kthen atë në një nga motorët ekonomik.

Për secilin minator do të ketë sigurim shëndetësor të avancuar, në mënyrë që shëndeti i tyre të mbrohet si parakusht për mirëqenien e atyre që punojnë në kushte të rënda.

## **54** RIGJENERIMI INDUSTRIAL I MITROVICËS

Mitrovica do të transformohet nga qytet i traumës historike në qendër industriale me potencial real zhvillimi.

Zona Ekonomike e Mitrovicës do të ketë kushte preferenciale: lehtësime tatimore afatgjata, infrastrukturë të plotë dhe lidhje logjistike me korridoret evropiane.

## **55** ZONAT INDUSTRIALE DHE KLASTERET SEKTORIALË

LDK do të ndërtojë zona industriale me infrastrukturë të plotë energjetike, logjistike dhe digjitale në çdo rajon.

Klasteret sektorialë: përpunim i drurit, metalet, ushqimi, teknologjia, tekstili – do të bashkojnë kompanitë vendore përmes ekspertizës së përbashkët dhe uljes së kostove operative.

Kompanitë që realizojnë mbi 50% të prodhimit të destinuar për eksport do të përfitojnë lehtësime tatimore specifike.

## **56** “MADE IN KOSOVË”: **SKEMA PREMIUM E EKSPORTIT**

LDK do të lansojë programin kombëtar “Made in Kosovë” si markë evropiane të besueshmërisë dhe cilësisë.

Produktet kosovare – nga verërat e deri te metalet e rafinuara dhe produktet teknologjike – do të futen në rrjetet premium të shitjes me pakicë në BE. Marrëveshje direkte me supermarketet kryesore evropiane në Gjermani, Austri, Zvicër dhe Itali, SHBA, etj., garantojnë prezencë fizike në raftet e tregjeve ndërkombëtare.

Midis të tjerash, Programi do të mbështesë certifikimin dhe standardizimin evropian të produkteve, pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare si Anuga, SIAL dhe Biofach, si dhe krijimin e platformës e-commerce për eksport direkt B2C në BE.

## **57** MBROJTJA E PRODHUESIT VENDOR

Rrjetet e mëdha të shitjes me pakicë që operojnë në Kosovë do të detyrohen me ligj të rezervojnë hapësirë minimale dhe kushte të drejta ekspozimi për produktet kosovare. Asnjë pengesë burokratike nuk mund të diskriminojë produktin vendor.

Supermarketet kosovare duhet të kenë produkte kosovare.

Bashkëpunimi me rrjetet e diasporës do të hapë kanale distribucioni jashtë vendit, duke lehtësuar eksportuesit e vegjël nga barra e logjistikës ndërkombëtare.



## KAPITULLI IX

# KOSOVA – DESTINACION I RI I TURIZMIT

Kosova ka resurse natyrore të jashtëzakonshme: male, liqene, lugina dhe trashëgimi kulturore kryesisht të pashfrytëzuara dhe të panjohura në arenën ndërkombëtare.

LDK investon në turizëm si industri afatgjate që krijon vende pune dhe nxit zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

## **58** BREZOVICA DHE PEJA: **RESORTE NDËRKOMBËTARE TË SKIJIMIT**

Brezovica dhe Peja kanë potencialin real të jenë destinacionet kryesore të skijimit në Evropën Juglindore.

Me borë natyrore, lartësi të përshtatshme dhe afërsi me kryeqytetet e rajonit; mungon vetëm investimi i duhur. LDK do të investojë direkt dhe do të tërheqë operatorë vendorë e ndërkombëtarë me eksperiencë në menaxhimin e resorteve malore.

Infrastruktura moderne e pistave dhe teleferikëve, hotele 4–5 yje, rrugë qasjeje me standard alpin dhe sezon i zgjatur deri në 5 muaj do ta transformojnë Brezovicën.

Ky investim përfshin rehabilitimin e pistave dhe ndërtimin e teleferikëve të rinj, rrugë qasjeje me standard evropian dhe parkingje të organizuara; aktivitete verore: destinacion 12-mujor; dhe partneritete me resorte të njohura ndërkombëtare. Investimi në këto resorte është rreth 200 milionë euro.

## **59 SHARRI: PARK KOMBËTAR DHE EKOTURIZËM**

Parku Kombëtar i Sharrit mbrohet si rezervë natyrore me rëndësi evropiane dhe njëkohësisht zhvillohet si destinacion ekoturizmi.

Shtigje të certifikuara, vendpushime ekoturistike dhe mbështetje direkte për bizneset lokale krijojnë ekonomi rurale të qëndrueshme.

## **60 DUKAGJINI: TURIZËM RURAL DHE TRASHËGIMI KULTURORE**

Lugina e Dukagjinit ka pasuri të rrallë: arkitekturë osmane, tradita autentike, gastronomia unike dhe peizazh të mahnitshëm.

LDK financon me grante deri 80% të investimeve private në bujtina tradicionale dhe biznese rurale.

Rruga turistike “Dukagjini Trail” lidh të gjitha atraksionet kryesore dhe certifikohet me standarde ndërkombëtare.

Tregu i produkteve artizanale dhe festivali vjetor kulturor ndërtojnë një brand ndërkombëtar të identifikueshëm.

## **61** INFRASTRUKTURA E TURIZMIT

Asnjë resort dhe asnjë destinacion nuk mund të funksionojë pa infrastrukturë aksesit.

LDK garanton rrugë të standardit evropian për të gjitha destinacionet kryesore turistike, sinjalistikë shumëgjuhëshe dhe sisteme moderne informacioni për vizitorët.

Bashkëpunimi me operatorët e tureve evropiane, prezenca në platformat kryesore ndërkombëtare të rezervimit dhe marketingu i koordinuar janë shtyllat e promovimit.



## KAPITULLI X

# KOSOVA – SHTET I INVESTIMEVE HISTORIKE

LDK beson se pasuria krijohet nga ndërmarrjet private,  
inovacioni dhe konkurrenca e lirë.

Shteti krijon kushtet; bizneset dhe qytetarët krijojnë  
pasurinë.

## **62 SIGURIA EKONOMIKE**

LDK zbaton mbrojtje të plotë të pronës private, tatim të ulët dhe të parashikueshëm pa ndryshime ad hoc, reduktim rrënjësor të barrës rregullative dhe hapje të plotë ndaj kapitalit privat vendor dhe të huaj.

Shteti duhet të jetë lehtësues, e jo drejtues dhe jo konkurrent i sektorit privat.

## **63 RRRITJA EKONOMIKE 5–7% DHE BUXHETI 5 MILIARDË EURO**

Synohet rritje reale e BPV-së prej 5–7% çdo vit, pra dyfishi i mesatares rajonale. Duke arritur një buxhet vjetor prej 5 miliardë euro deri në fund të mandatit, 30% e tij, përkatësisht rreth 1.5 miliardë euro në vit, do të shkojnë direkt si investime kapitale.

Totali i investimeve publike gjatë katër viteve tejkalon 5 miliardë euro.

Motorët kryesorë të rritjes janë energjia, industria dhe përpunimi, teknologjia, ICT dhe digjitalizimi, turizmi dhe bujqësia e modernizuar.

## **64** MBËSHTETJA E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë 85% të ekonomisë kosovare dhe janë ofruesi kryesor i vendeve të punës.

LDK i mbështet përmes skemave të garancisë kreditore, granteve për teknologji dhe digjitalizim dhe trajnimeve profesionale. Qeveria nuk do të jetë konkurrente e bizneseve të vogla, por do të jetë partnere e tyre e besueshme.

Rregullat e qarta, të qëndrueshme dhe të drejta janë gjithçka që kërkon ndërmarrësi kosovar për të ndërtuar biznesin e tij.

## **65** BUJQËSIA E MODERNIZUAR DHE SUBVENCIONET BAZUAR NË PRODHIM

LDK kalon nga skema e subvencionimit bazuar në sipërfaqe toke në skema të bazuara në prodhimin real.

Fermeri që prodhon më shumë dhe me cilësi më të lartë merr mbështetje më të madhe.

Heqja e akcizës në naftë për fermerët ul menjëherë koston e prodhimit.

Sigurimet bujqësore subvencionohen 50%, sipërfaqet e ujitura dyfishohen dhe Fondi i Zhvillimit Rural rritet me 100 milionë euro gjatë mandatit.

## **66** AVIOKOMPANIA KOMBËTARE

LDK do të ndërtojë aviokompaninë kombëtare me flotë 4–8 avionësh, me 70 milionë euro investim publik dhe rreth 100 milionë euro investim privat.

Lidhjet direkte Prishtinë – qytetet e diasporës, si Frankfurt, Zürich, Milano, Londër, Stokholm, do të ulin koston e fluturimit dhe do të hapin rrugë të reja tregtare. Qytetarët e Kosovës nuk duhet të udhëtojnë nga Tirana apo Shkupi për të arritur destinacionin e tyre.

Kjo nuk është vetëm çështje komoditeti, por edhe çështje dinjiteti dhe sovraniteti ekonomik.

## **67 PËRFUNDIMI I TË GJITHA MAGJISTRALAVE DHE AUTOSTRADAVE BRENDA MANDATIT**

Të gjitha magjistralet ekzistuese do të përfundojnë me standarde evropiane - brenda mandatit. Do të përfundojmë edhe Unazën e Jashtme të Prishtinës në vlerë prej 300 milionë euro, e cila çliron kryeqytetin nga trafiku dhe krijon korridore të reja zhvillimore.

Autostrada e Anamoravës dhe Magjistranja e Pejës do të ndërtohen njëkohësisht.

## **68 MODERNIZIM I HEKURUDHAVE**

Kosova ka nevojë për një rrjet modern hekurudhor që lidh qytetet, lehtëson transportin e mallrave dhe ul kostot ekonomike.

Prandaj, do të investojmë rreth 100 milionë euro në tri projekte strategjike hekurudhore: rehabilitimin e linjës Xërxe – Prizren, me investim prej rreth 25 milionë euro, për të lidhur Prishtinën me Prizrenin përmes

Fushë Kosovës; rehabilitimin e linjës Klinë – Pejë, me investim prej rreth 22 milionë euro; si dhe përfundimin e rehabilitimit të linjës Hani i Elezit – Fushë Kosovë, përfshirë modernizimin e stacioneve të trenit përgjatë gjithë korridorit.

Këto investime do të krijojnë transport më të shpejtë, më të sigurt e më të lirë për qytetarët dhe bizneset, do të reduktojnë ngarkesën në rrugë dhe do ta bëjnë Kosovën pjesë më funksionale të rrjeteve moderne rajonale të transportit.

## 69

## UNAZA E JASHTME E PRISHTINËS

Prishtina nuk mund të vazhdojë të mbetet peng i trafikut, bllokadave ditore dhe mungesës së planifikimit urban.

Prandaj, LDK do të ndërtojë Unazën e Jashtme të Kryeqytetit, një nga projektet më të mëdha infrastrukturore në vend, me investim prej rreth 300 milionë euro, që do të transformojë qarkullimin në dhe rreth Prishtinës.

Kjo unazë do të largojë trafikun tranzit nga qendra urbane, do të ulë kohën e udhëtimit, ndotjen dhe kostot ekonomike të

bllokimeve, ndërsa njëkohësisht do të krijojë korridore të reja zhvillimore për banim, biznes dhe industri.

Për Kryeqytetin dhe gjithë Kosovën, kjo nuk është vetëm rrugë e re - është zgjidhje strategjike për mobilitetin, zhvillimin urban dhe cilësinë e jetës.

## **70** **1.5 MILIARDË EURO** **INVESTIME NË KRYEQYTET**

LDK do të investojë mbi 1.5 miliardë euro në Kryeqytet, në një transformim të plotë të Prishtinës përmes projekteve madhore infrastrukturore, përfshirë Unazën e Jashtme të Kryeqytetit, zgjerimin e rrjetit rrugor dhe transportit urban, investimet në ujë e energji, si dhe përmes implementimit të mësimit tërëditor dhe ndërtimit të infrastrukturës së re arsimore e çerdheve.

Në shëndetësi, Prishtina do të jetë qendra e transformimit të sistemit përmes ndërtimit të QKUK-së së re, Spitalit të Prishtinës, si dhe investimeve të tjera moderne shëndetësore që do të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e jetës në Kryeqytet.


## **71** **VAZHDIMI I AUTOSTRADËS** **“IBRAHIM RUGOVA” DERI NË** **MERDARE**

Ky projekt do të shërbejë si një komponentë kyçe në rrjetin kryesor rrugor të Evropës, duke i lidhur korridoret rrugore Pan-Evropiane me portet në bregdetin e Adriatikut.

Duke e implementuar këtë projekt, planet që përbëjnë hartën ekzistuese ndërkombëtare të rrugëve do të zbatohen, por gjithashtu edhe planet e caktuara në marrëveshjet dhe rregullimet e vendosura të Bashkimit Evropian.

Kostoja e këtij projekti është rreth 250 milionë euro. Ai do të realizohet vetëm në rast të sigurimeve të mjeteve financiare nga Bashkimi Evropian, si pjesë e një investimi rajonal.

Fokusi ynë primar, i lidhjes së Kryeqytetit me Llapin, brenda mandatit katërvjeçar, mbetet rruga magjistrale Besi - Podujevë.



## KAPITULLI XI

# KOSOVA – SHTET I TRANSFORMIMIT DIGJITAL

Inteligjenca Artificiale dhe Sektori ICT janë mundësia strategjike e Kosovës për të kapërcyer modelin tradicional të zhvillimit dhe për të hyrë direkt në ekonominë e shekullit XXI.

Me popullsi të re, arsimim gjuhësor të shkëlqyer dhe kosto konkurruese, Kosova mund të bëhet destinacioni kryesor për kompanitë globale në zhvillimin e Inteligjencës Artificiale dhe produkteve të ekonomisë digjitale.

## **72** INVESTIMET PUBLIKE DIGJITALE

Shteti investon 120 milionë euro në infrastrukturën digjitale publike: cloud-in kombëtar qeveritar të sigurt, rrjet broadband me qasje universale, duke përfshirë zonat rurale dhe qendra të dhënash sovrane që garantojnë pavarësi nga infrastruktura e huaj dhe e pasigurt.

Sistemi i unifikuar qeveritar i komunikimit dhe menaxhimit të detyrave mundëson llogaridhënie në kohë reale: çdo detyrë e çdo zyrtari është e matshme, e gjurmueshme dhe e raportueshme.

## **73** ICT SI SEKTOR EKONOMIK: INVESTIMET PRIVATE

Ndërkohë, sektori privat ICT nxitet me zona të posaçme inovacioni dhe lehtësime tatimore afatgjata, procedura të thjeshtuara për investitorët e huaj dhe fondin kombëtar 40 milionë euro për AI, inovacion dhe startup-e, kërkim dhe zhvillim.

Synimi konkret: të paktën një kompani ndërkombëtare nga Top-20 të sektorit teknologjik të hapë qendër operationale në Kosovë deri në vitin 2030 dhe 500 milionë euro eksporte ICT deri në vitin 2030.

## **74** INTELIGJENCA ARTIFICIALE SI PRIORITET KOMBËTAR

Fondi Kombëtar i AI-së me 40 milionë euro financon projekte pilot për integrimin e AI-së në prokurimin publik, sistemin gjyqësor dhe administratën shtetërore. Kosova pozicionohet si lider rajonal në adoptimin e teknologjive të reja.

## **75** DIGJITALIZIMI I PLOTË I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Të gjitha shërbimet publike kalojnë online brenda mandatit.

Platforma e unifikuar e-Kosova integron të gjitha ministritë dhe institucionet: qytetari jep të dhënën njëherë, sistemi e ndan automatikisht të të gjithë të interesuarit. Zero dublikime, zero radhë të panevojshme. Qendra digjitale e dedikuar për diasporën u mundëson kosovarëve jashtë vendit të marrin të gjitha shërbimet shtetërore pa ardhur fizikisht.

Dokumente, vërtetime, regjistrime kryhen të gjitha nga kompjuteri ose telefoni.

## **76** AI DHE KODIMI NË KURRIKULËN SHKOLLORE

Modulet e AI-së dhe Kodimit futen në kurrikulën shkollore që nga klasa e katërt. Mësuesit trajnohen përmes një programi specifik kombëtar dhe materialet zhvillohen origjinalisht në gjuhën shqipe.

Fëmijët mësojnë mendimin kompjuterik, algoritmet dhe etikën e AI-së paralelisht me shkencat tradicionale.

## **77** RRJETI I DIASPORËS TEKNOLOGJIKE

Kosovarët në Silicon Valley, Londër, Berlin, Zürich dhe qendrat e tjera botërore aktivizohen si mentorë, investitorë dhe partnerë të startup-eve kosovare përmes platformës kombëtare të dedikuar.

Rrjeti ndërkombëtar i Alumni-ve dhe diasporës ICT është aset strategjik për zhvillim ekonomik të vendit.

## **78** INTEGRIMI NË TREGUN UNIK DIGJITAL TË BE-SË

Adoptimi i standardeve evropiane digjitale, përfshirë nënshkrime elektronike ligjore, mbrojtjen e të dhënave personale sipas GDPR dhe sigurinë kibernetike, hap rrugën drejt tregut unik digjital evropian me 450 milionë konsumatorë.

Kompania kosovare që plotëson standardet evropiane mund të shesë direkt në çdo vend të BE-së pa barriera teknike apo ligjore.

## **79** SJELLJA E NJË INVESTIMI TË MADH STRATEGJIK NË TEKNOLOGJI DHE INTELIGJENCË ARTIFICIALE

Kosova do të bëhet destinacion për investimet më të mëdha teknologjike të kohës sonë.

Do të sjellim një investim strategjik të përmasave të mëdha në fushën e qendrave të të dhënave dhe inteligjencës artificiale (Data Center & AI Hub), duke e pozicionuar Kosovën si nyje rajonale për përpunim digjital, cloud computing dhe teknologji të avancuara.

Përmes një pakete të veçantë shtetërore, që përfshin infrastrukturë energjetike të qëndrueshme me gaz amerikan, tokë strategjike, lehtësira fiskale dhe kuadër të përgatitur profesional - do të tërheqim kompani globale të teknologjisë dhe investime transformuese të ngjashme me qendrat më të mëdha të inovacionit në botë.

Ky investim do të krijojë dhjetëra mijëra vende pune të mirëpaguara, do të fuqizojë sektorin ICT, do të rriste eksportin e shërbimeve digjitale dhe do ta kthejë Kosovën në një ekonomi të së ardhmes



## KAPITULLI XII

# KOSOVA – SHTET I FAMILJES DHE RINISË

Rënia demografike po shndërrohet në emergjencë kombëtare. Kosova humb çdo vit qytetarë të rinj dhe të arsimuar dhe kjo është krizë ekonomike, sociale dhe ekzistenciale njëkohësisht.

LDK do të përgjigjet me politika fiskale të guximshme dhe konkrete. Si parti e djathtë, fuqizimin e familjes e kemi shtyllë themelore të angazhimit tonë politik

## **80** 200 EURO MUJORE PËR FËMIJËN E PORSALINDUR

Çdo fëmijë i porsalindur kosovar merr 200 euro në muaj gjatë vitit të parë të jetës. Kjo nuk është ndihmë sociale - është investim demografik kombëtar dhe sinjali ynë i qartë: Kosova dëshiron familje të reja dhe i mbështet ato konkretisht për jetë të dinjitetshme.

Masa lehtëson shpenzimet fillestare ndër më të lartat për çdo familje dhe njëkohësisht ul presionin ekonomik që i detyron çiftet e reja të shtyjnë vendimin për fëmijë apo të marrin rrugën jashtë vendit.

## **81** 5,000 EURO PËR FËMIJËN E TRETË

Çdo çift që lind fëmijën e tretë merr 5,000 euro ndihmë të drejtpërdrejtë nga shteti. Transferta bëhet brenda 30 ditëve nga regjistrimi i lindjes.

Ky investim fiskal i guximshëm është i nevojshëm për të kthyer trendin demografik negativ. Vendet evropiane me politika të ngjashme kanë arritur rezultate të matshme brenda një dekade.

## **82** **MINISTRIA E FAMILJES DHE MIRËQENIES**

Krijohet Ministria e Familjes, si organ i dedikuar për koordinimin institucional të plotë të të gjitha politikave demografike, sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve.

Sot këto politika janë shpërndarë pa koordinim në shumë ministri, me rezultate të dobëta dhe burime të shpërdoruar.

Ministria e Familjes i jep fund fragmentimit dhe siguron qasje të unifikuar, buxhet të konsoliduar dhe vlerësim të qartë të rezultateve çdo vit.

## **83** **REFORMA E SISTEMIT TË PENSIONEVE**

Sistemi kontributdhënës i pensioneve modernizohet për të garantuar drejtësi, parashikueshmëri dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Pensioni i nesërm do të pasqyrojë direkt kontributet e sotme, pa vendime politike arbitrare dhe pa ndikimin e koniunkturave buxhetore, por me ligj dhe skema pensionale transparente dhe të parashikueshme.

Transparenca e plotë e llogarive individuale të pensioneve, qasja online dhe garancia ligjore e kontributeve e bëjnë sistemin të besueshëm. Qytetari di sot çfarë do të marrë nesër.

## 84

## **GARANTIM ME LIGJ I SHITESAVE PËR FËMIJË DHE LEHONA**

Mbështetja për fëmijët dhe familjet duhet të jetë e garantuar dhe e paprekshme. Prandaj, do të rregullojmë me ligj dhënia e shtesave për fëmijë, duke përcaktuar qartë kriteret, shumën dhe mekanizmat e financimit, në mënyrë që çdo familje përfituese të ketë siguri të plotë dhe parashikueshmëri afatgjatë.

Me këtë zgjidhje ligjore, asnjë shtesë ekzistuese nuk do të hiqet apo të cenohet; përkundrazi, mbështetja për familjet do të mbrohet nga çdo ndryshim arbitrar apo kalkulim politik i radhës.

Fëmijët e Kosovës nuk janë barrë buxhetore, por investimi më i rëndësishëm i Republikës.



## KAPITULLI XIII

# KOSOVA – SHTET I KULTURËS

Kultura nuk është luks por është themeli mbi të cilin ndërtojmë identitetin kombëtar, turizmin dhe ekonominë krijuese.

## **85** **TEATRI I OPERËS DHE BALETIT** **“DR. IBRAHIM RUGOVA”**

LDK do të ndërtojë Teatrin e Operës dhe Baletit me 25 milionë euro investim publik brenda katër viteve.

Teatri me 800 vende dhe standarde akustike evropiane do të jetë platformë për kompanitë ndërkombëtare dhe grupet kosovare njëkohësisht.

Programet edukative për fëmijë dhe rezidencat artistike transformojnë kulturën nga një ngjarje elitare në pjesë të jetës publike.

## **86** **MODERNIZIMI I MUZEUT** **KOMBËTAR**

Një investim 15 milionë euro mundëson rindërtimin dhe modernizimin e plotë të Muzeut Kombëtar të Kosovës sipas standardeve ndërkombëtare.

Ekspozitat e përhershme dhe të përkohshme me ndriçim, siguri dhe prezantim modern e bëjnë muzeun destinacion të vërtetë kulturor.

Digjitalizimi i plotë i koleksioneve e bën trashëgiminë kosovare të aksesueshme edhe për diasporën dhe për vizitorët e huaj online.

## **87 FONDI KOMBËTAR I KULTURËS**

LDK do të krijojë fond vjetor prej 10 milionë euro për mbështetjen direkte të artistëve, shkrimtarëve, regjisorëve dhe muzikantëve kosovarë përmes granteve individuale dhe bashkëfinancimit të projekteve.

Grante individuale deri 10,000 euro, bashkëfinancim filmash dhe muzike, rezidenca artistike ndërkombëtare dhe platforma “Kosova Creates” për shitjen e produkteve kulturore online janë instrumentet konkrete të këtij fondi.

## **88 PARQET ARKEOLOGJIKE: ULPIANA DHE DRESNIKU**

Ulpiana dhe Dresniku janë trashëgimi arkeologjike të panjohura të Kosovës. LDK financon funksionalizimin e plotë të tyre si destinacione turistike dhe kërkimore me infrastrukturë për vizitorë dhe qendra interpretuese.

Bashkëpunimi me universitetet evropiane dhe procesi i certifikimit nga UNESCO si trashëgimi botërore janë objektiva brenda mandatit.

Këto parqe mund të tërheqin dhjetëra mijëra vizitorë çdo vit dhe të kthejnë investimin brenda pesë viteve.

## **89** SHTËPITË E KULTURËS DHE BIBLIOTEKAT KOMUNALE

Çdo komunë ka shtëpinë e saj të kulturës dhe bibliotekën e rinovuar dhe të pajisur me teknologji moderne. Platforma kombëtare digjitale e leximit ofron qasje falas në mijëra tituj shqip dhe ndërkombëtarë nga çdo pajisje. Çdo fëmijë në çdo fshat të Kosovës duhet të ketë qasje në kulturë dhe libra.

## **90** MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE

Program sistematik i restaurimit të monumenteve kulturore dhe fetare, dhe ndërtesave historike financohet bashkërisht nga buxheti kombëtar dhe fondet evropiane IPA dhe Creative Europe.

Ligji i rishikuar i trashëgimisë kulturore forcon mbrojtjen ligjore dhe sanksionet. Ajo çka nuk e ruajmë sot e humbasim përgjithmonë - kjo nuk është retorikë, por fakt.

## **91** INDUSTRIA FILMIKE KOSOVARE

Fondi i filmit kosovar me 10 milionë euro vjetore, bashkë me skemën e rabateve, financon filmat kombëtarë dhe koproduksionet me vendet evropiane. Studiot profesionale të prodhimit filmik dhe trajtimet tatimore preferenciale për produksionet e huaja tërheqin xhirime ndërkombëtare.

Festivali Ndërkombëtar i Filmit të Prishtinës bëhet ngjarje e kalendarit kulturor evropian.

## **92** NDËRTIMI I OBJEKTIT TË RI TË TEATRIT KOMBËTAR

LDK do të ndërtojë objekt të ri modern për Teatrin Kombëtar, duke krijuar kushte dinjitoze për skenën teatrore të vendit. Objekti aktual do të shndërrohet në Teatrin e Qytetit të Prishtinës me investim prej 10 milionë eurosh.

Ky transformim fuqizon prodhimin artistik dhe rrit qasjen e publikut në teatër.

## **93 MUZEU I ARTIT BASHKËKOHOR**

Muzeu i Artit Bashkëkohor do të krijojë hapësirë të dedikuar për artin modern dhe bashkëkohor, duke promovuar artistët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Investimi prej 10 milionë eurosh siguron standarde profesionale për ekspozim dhe për zhvillimin e programeve kulturore. Ky institucion e vendos Kosovën në hartën e kulturës bashkëkohore evropiane.

## **94 THEMELIMI I QENDRËS SË LIBRIT**

Qendra e Librit do të jetë institucioni qendror për promovimin e letërsisë, bursave letrare, programeve të përkthimit dhe mbështetjes për shkrimtarët.

Ajo synon rritjen e qarkullimit të librit dhe forcimin e kapaciteteve krijuese vendore. Ky institucion e afirmon librin si mjet të zhvillimit kulturor dhe arsimor.

## 95 MUZEU I PAQES DHE REZISTENCËS

Muzeu i Paqes dhe Rezistencës do të ndërtohet me investim prej 10 milionë eurosh si qendër identitare dhe historike e Kosovës.

Ai do të dokumentojë rrugën e popullit të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Ky muze do të jetë referencë kombëtar e ndërkombëtare për historinë tonë moderne.

## 96 PAVARËSIMI I INSTITUCIONEVE KULTURORE

LDK synon rritjen e autonomisë buxhetore dhe funksionale të institucioneve kulturore për të garantuar kreativitet, qëndrueshmëri dhe profesionalizëm.

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Kulturës me plan dhjetëvjeçar siguron zhvillim të planifikuar dhe koherent.

Kjo qasje i jep kulturës statusin që meriton në jetën publike.

## **97** QENDRAT MULTIFUNKSIONALE PËR ART DHE KULTURË

LDK do të identifikojë objekte të braktisura me vlerë trashëgimie dhe do t'i rikthejë ato në hapësira kulturore përmes projekteve kreative me komunitetin artistik. Qendrat multifunktionale do të shërbejnë për ekspozita, performanca dhe aktivitete rinore.

Kjo politikë rigjallëron hapësirat urbane dhe nxit pjesëmarrjen kulturore.



## KAPITULLI XIV

# KOSOVA – SHTET I SPORTIT DHE KAMPIONËVE

Sporti kosovar i ka treguar botës kush jemi - me medalje olimpike dhe arritje ndërkombëtare në kushte të vështira dhe me burime minimale.

Tani ka ardhur koha të investojmë ashtu siç meritojnë atletët tanë dhe kombi ynë.

## **98 STADIUMI KOMBËTAR**



LDK do të ndërtojë Stadiumin Kombëtar me kapacitet prej 30,000 vende sipas standardeve të FIFA-s dhe UEFA-s, me kushte të domosdoshme për organizimin e ndeshjeve ndërkombëtare zyrtare.

## **99 QENDRA KOMBËTARE E SPORTIT**



LDK do të ndërtojë kompleksin e plotë sportiv kombëtar: Pallati Kombëtar i Sportit me 10,000 vende, Pishinën Olimpikë 50 metra me standarde FINA dhe Arenën e dedikuar për xhudo – sportit që ka sjellë medaljet olimpikë të Kosovës.

Investimi total është 110 milionë euro brenda katër viteve.

## **100 PESË STADIUME RAJONALE – TË STANDARDEVE TË UEFA-S**



Pesë stadiume të reja do të ndërtohen në qendra të ndryshme të Kosovës, nga 12 milionë euro secili, me standarde të UEFA-s, kategoria 3–4.

Investimi total 60 milionë euro transformon infrastrukturën sportive jashtë kryeqytetit.

## **101** PROGRAMI KOMBËTAR I TALENTEVE SPORTIVE

Identifikimi dhe zhvillimi sistematik i talenteve sportive fillon nga mosha 6-vjeç nëpërmjet 40 qendrave rajonale të talenteve.

Çdo fëmijë me potencial, pavarësisht vendbanimit dhe gjendjes ekonomike të familjes, do të ketë qasje të garantuar në trajnim profesional.

1,000 bursa vjetore do të financojnë plotësisht atletët e rinj me potencial ndërkombëtar.

## **102** MBËSHTETJA E FEDERATAVE SPORTIVE

Financimi i drejtpërdrejtë dhe i qëndrueshëm i federatave sportive kombëtare do të trefishohet.

## 103 SPORTI SHKOLLOR



Dy orë sport të detyrueshëm çdo ditë në çdo shkollë bëhen standard kombëtar ligjor. Garat shkollore sistematike organizohen çdo vit në futboll, basketboll, atletikë, xhudo dhe not.

Liga Kombëtare Shkollore do të identifikojë talentet.

Sallat sportive do të përdoren edhe nga komuniteti. 50 milionë euro do të investohen në salla sportive shkollore, aty ku mungojnë.

Çdo shkollë e re e ndërtuar do të ketë sallë sportive me standarde të plota.

## 104 INFRASTRUKTURA SPORTIVE KOMUNALE



100 fusha mini-futbolli dhe terrene multisport do të ndërtohen në lagjet dhe fshatrat me 15 milionë euro investim.

50 pishina publike me çmim të subvencionuar do të hapin mundësinë e notit për çdo fëmijë kosovar.

A high-angle photograph of a mountain valley. In the foreground, there are rocky, green slopes leading down to a calm, dark blue lake. The middle ground shows a valley floor with patches of green grass and small streams. In the background, rugged mountain peaks are visible, some with patches of snow or light-colored rock. The sky is clear and blue.

## KAPITULLI XV

# KOSOVA – SHTET I GJELBËR DHE I PASTËR

Mjedisi është trashëgimia më e çmuar që u lëmë brezave që vijnë. LDK paraqet vizionin për vendosjen e rendit dhe standardeve në ndërtim, modernizimin e planifikimit hapësinor dhe mbrojtjen e mjedisit në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian.

Synimi është krijimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe të rregullt, duke mbrojtur resurset natyrore, trashëgiminë kulturore dhe të drejtën e qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm.

## **105** PËRDITËSIMI I PLANIT HAPËSINOR DHE HARTËS ZONALE

LDK synon përditësimin e plotë të Planit hapësinor dhe Hartave zonale në përputhje me ligjet e ndërtimit, trashëgimisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Ky proces krijon bazën e saktë për zhvillim të rregullt urban dhe rural.

Harmonizimi ligjor siguron qartësi dhe shmang abuzimet.

## **106** THEMELIMI I EKO-FONDIT (50 MILIONË €)

Krijohet Eko-Fondi me kapital prej 50 milionë eurosh për pastrimin e Kosovës nga mbeturinat dhe rehabilitimin e zonave të ndotura.

Fondi do të financojë projekte komunale dhe ndër-komunale për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave. Qëllimi është rikthimi i mjedisit të pastër dhe rritja e cilësisë së jetës.

## **107** DIGJITALIZIMI I PROCESIVE TË LEJEVE DHE VENDIMARRJES

Lejet e ndërtimit dhe vendimmarrjet urbane do të digjitalizohen për transparencë dhe efikasitet më të lartë.

Sistemi digjital eliminon abuzimet, vonesat dhe ndërhyrjet e paautorizuara.

Qytetarët dhe bizneset përfitojnë shërbime më të shpejta e më të sigurta.

## **108** RUAJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE RESURSEVE NATYRORE

LDK parashikon mbrojtje aktive të trashëgimisë kulturore dhe zonave natyrore në përputhje me standardet e BE-së.

Zbatimi rigoroz i kriterëve garanton ruajtjen e identitetit dhe biodiversitetit.

Kjo politikë balancon zhvillimin me mbrojtjen e vlerave kombëtare.

## **109** PËRFSHIRJA E STANDARDEVE TË EU GREEN DEAL

Politikat mjedisore të Kosovës do të përafrohen me EU Green Deal për të mundësuar tranzicion të gjelbër dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Kjo nënkupton energji të pastër, efikasitet dhe ulje të ndotjes.

Aprovimi i këtyre standardeve e afron vendin me BE-në.

## **110** RISHIKIMI I STRATEGJIVE SEKTORIALE MJEDISORE

Strategjitë për ajrin, ujin, biodiversitetin, mbeturinat dhe ekonominë qarkore do të rishikohen dhe përshtaten me nevojat aktuale.

Kjo siguron politika më funksionale dhe realiste për mjedisin.

Përditësimi i strategjive rrit koordinimin dhe efektivitetin institucional.

## **111 FORCIMI I STANDARDEVE KOMBËTARE TË MJEDISIT**

LDK do të përditësojë standardet e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës për t'i përafuar me normat evropiane.

Ky proces forcon mbrojtjen e shëndetit publik dhe të ekosistemeve.

Standardet e reja sigurojnë monitorim më të saktë dhe masa më efektive për reduktim të ndotjes.

## **112 NGRITJA E KAPACITETEVE INSPEKTUESE**

Do të pesëfishohet numri i inspektorëve të ndërtimit, mjedisit dhe planifikimit për të garantuar kontroll efektiv në terren.

Rritja e kapaciteteve inspektuese ndalon ndërtimet pa leje dhe ndotjen.

Qasja proaktive rrit përgjegjësinë dhe respektimin e ligjit.

## **113** FUNKSIONALIZIMI I LABORATORËVE TË MJEDISIT

Kosova do të forcojë kapacitetet e laboratorëve për monitorimin e cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës.

Pajisjet moderne dhe standardet shkencore rrisin besueshmërinë e të dhënave mjedisore. Laboratorët bëhen mjet kyç për politikat dhe masat mbrojtëse.



**LDK 113**



**BASHKOHU!**

